



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 90

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E mërkurë, 29 maj 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 182, datë 22.5.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10187
Dekret i Presidentit nr. 183, datë 22.5.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10187
Dekret i Presidentit nr. 184, datë 22.5.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10187
Dekret i Presidentit nr. 185, datë 22.5.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10188
Dekret i Presidentit nr. 186, datë 22.5.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10188
Dekret i Presidentit nr. 187, datë 22.5.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10188
Dekret i Presidentit nr. 188, datë 22.5.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10189
Dekret i Presidentit nr. 189, datë 22.5.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10189
Dekret i Presidentit nr. 190, datë 22.5.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10189
Dekret i Presidentit nr. 191, datë 22.5.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10190
Dekret i Presidentit nr. 192, datë 22.5.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 10190

Dekret i Presidentit nr. 193, datë 22.5.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	10190
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 314, datë 24.5.2024	Për lirim nga detyra të prefektit të Qarkut të Elbasanit.....	10191
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Brendshëm nr. 3, datë 16.4.2024	Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kriteret, procedurën dhe mënyrën e bashkëpunimit dhe të mbështetjes së përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë nga Policia e Shtetit.....	10191
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 5.3.2024	Çështja Jella dhe të tjerë kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 7564/07</i>).....	10193
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 2.5.2024	Valbona Bala kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 21141/20</i>).....	10197
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nr. 141(891), datë 22.2.2024	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Patrik Boshi.....	10209
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nr. 140(890), datë 22.2.2024	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Erjon Sherri	10209
Vendimi Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nr. 151(967), datë 27.2.2024	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Ardian Peniku	10209
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nr. 256(1652), datë 2.4.2024	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasës Ganxhe Mustali	10209
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nr. 181(1179), datë 5.3.2024	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Ermal Dibra	10209
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nr. 235(1541), datë 26.3.2024	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Rigail Lishi	10209

**DEKRET****Nr. 182, datë 22.5.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Momčilo Gligo Zlatičanin
2. Elsa Injac Marku (Dedi)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 183, datë 22.5.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Alma Ramadan Bitro (Çela)
2. Nadia Endrit Bitro
3. Christian Endrit Bitro
4. Endrit Pasko Bitro

5. Erlis Amir Curaj
6. Orgesa Dashnor Osmani
7. Benard Pal Ndoca

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 184, datë 22.5.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ana Arjan Beqo
2. Paolo Petrit Doksani
3. Denis Arben Gardalina
4. Ergenta Sazan Metaj
5. Sindi Blend Barbuta

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 185, datë 22.5.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Fatmir Alush Likja
2. Gerti Eduart Bizhuta
3. Graciano Enver Çaushti
4. Erind Qamil Asllani
5. Iris Erind Asllani
6. Ella Ammaniel Erind Asllani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 186, datë 22.5.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Klajdi Kristaq Nikolla
2. Xhoni Orlandi Mone
3. Florian Fatos Mema
4. Laureta Sadik Xhaferaj
5. Daniela Vincenzo Mirdita

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 187, datë 22.5.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Diana Ago Shametaj
2. Alfred Petraq Bushi
3. Eduarta Hajdar Muçollari
4. Shkëlqim Enver Koçi
5. Sara Skënder Bregasi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



DEKRET
Nr. 188, datë 22.5.2024

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Henri Agron Sadiraj
2. Xhorxhina Petrit Taraj
3. Alma Isuf Loka
4. Albana Astrit Muka

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 189, datë 22.5.2024

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Enrik Frederik Marku
2. Alket Pandeli (s) Foni (s)

3. Etleva Memet Malaj (Meçanaj)
4. Shaq Abdyl Karakushi
5. Gracelyn Andi Gjika

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 190, datë 22.5.2024

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Kelvi Blend Barbuta
2. Isa Sabri Domi
3. Hana Isa Domi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



DEKRET
Nr. 191, datë 22.5.2024

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Donald Shpëtim Hoxha
2. Leonidha Leonidha Prifti
3. Mariela Vasil Bregu
4. Aleksander Mikel Marku
5. Rafael Aleksander Marku
6. Emily Aleksander Marku
7. Ndriçim Ramis Behari

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 192, datë 22.5.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Sadik Behzat Shporta
2. Gjokë Nikollë Osmani
3. Rilind Bedri Çejku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 193, datë 22.5.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Rita Gegë Kryeziu
2. Homez Bajram Letaj
3. Kreshnike Bajram Tarashaj (Islamaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



VENDIM
Nr. 314, datë 24.5.2024

PËR LIRIMIN NGA DETYRA
TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË ELBASANIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Majlinda Perriu, prefekt i qarkut të Elbasanit, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 3, datë 16.4.2024

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
TË HOLLËSISHME PËR KRITERET,
PROCEDURËN DHE MËNYRËN E
BASHKËPUNIMIT DHE MBËSHTETJES
SË PËRMARUESVE GJYQËSORË
SHTETËRORË NGA POLICIA
E SHTETIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 42, pika 3 të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, ministri i Brendshëm dhe ministri i Drejtësisë,

UDHËZOJNË:

I. QËLLIMI

1. Ky udhëzim ka për qëllim:

a) përcaktimin e kriterëve dhe rregullave të zbatueshme procedurale, mbi bazën e të cilave kërkohet dhe jepet mbështetja nga strukturat e Policisë së Shtetit për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë, në ndihmë të përmbaruesve të shërbimit

publik për kryerjen e veprimeve procedurale në realizimin e një procesi përmbarimor;

b) përcaktimin e mënyrës së bashkëpunimit dhe mbështetjes së përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë nga Policia e Shtetit, para, gjatë dhe pas kryerjes së veprimeve përmbarimore përkatëse.

II. KRITERET DHE PROCEDURA QË
NDIQET NGA PËRMARUESIT GJYQË-
SORË SHTETËRORË PËR BASHKËPU-
NIMIN ME POLICINË E SHTETIT

1. Nevoja për ndihmë, prezencë dhe mbështetje nga Policia e Shtetit është e domosdoshme në rastet kur, përmbaruesi gjyqësor shtetëror çmon të arsyeshme se veprimet procedurale përmbarimore nuk mund të kryhen pa mbështetjen, ndihmën dhe prezencën e Policisë së Shtetit, pasi ekzekutimi i tyre paraqet rrezik për jetën, shëndetin dhe dinjitetin e:

a) përmbaruesit gjyqësor shtetëror;

b) personave të tjerë që do të asistojnë dhe janë të pranishëm gjatë ekzekutimit;

c) kreditorit apo debitorit.

2. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror kryen dhe argumenton vlerësimin e nevojës për mbështetje nga strukturat e Policisë së Shtetit gjatë kryerjes së veprimit përmbarimor në terren. Ai vlerëson, kur:

a) mund të cenohet rëndë procesi përmbarimor nga pengesa e debitorit, personit të barazuar me të ose personit të tretë;

b) ekziston një pamundësi për kryerjen e një veprimi përmbarimor konkret dhe të nevojshëm;

c) mund t'i cenohet jeta, morali dhe integriteti shoqëror subjekteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu.

3. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror që ka vlerësuar të nevojshme ndihmën, prezencën apo mbështetjen e Policisë së Shtetit, vepron si më poshtë:

a) paraqet kërkesë me shkrim, sipas formatit të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, pranë strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit (komisariat apo drejtori vendore), që ka në juridiksion vendin ku do të kryhet ekzekutimi, 5 (pesë) ditë përpara datës së përcaktuar për kryerjen e procedurës së ekzekutimit, duke argumentuar në lidhje me rrezikun, vështirësitë, pengesat e hasura apo të mundshme gjatë ekzekutimit, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij kreu;

b) në raste emergjence, kur është e nevojshme për të parandaluar rrezikun ndaj jetës, shëndetit ose pronës së përmbaruesit gjyqësor shtetëror, ndihma dhe prania e punonjësve të Policisë së Shtetit mund



të kërkohet edhe verbalisht. Në këto raste, përmbaruesi gjyqësor shtetëror i paraqet drejtuesit të strukturës vendore të Policisë së Shtetit ku kryen veprimet përmbarimore, një informacion me shkrim jo më vonë se 2 (dy) ditë nga kalimi i gjendjes së emergjencës.

4. Kërkesa për mbështetje, prezencë ose ndihmë shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) fotokopje të dokumentit të identifikimit të përmbaruesit gjyqësor shtetëror;

b) fotokopje të urdhrit të ekzekutimit të lëshuar nga gjykata dhe për ato raste që nuk lëshohet urdhër, dërgohet fotokopje e titullit ekzekutiv.

5. Kopjet e dokumenteve të mësipërme njehsohen me vulën e zyrës përmbarimore ku ushtron detyrën përmbaruesi gjyqësor shtetëror përkatës.

6. Anulimi, ndryshimi i datës dhe/ose orës së kërkesës për ndihmë, prezencë apo mbështetje nga Policia e Shtetit të përmbaruesit gjyqësor shtetëror, bëhet me njoftim paraprak me shkrim të përmbaruesit gjyqësor shtetëror, i cili i drejtohet strukturës vendore të Policisë së Shtetit ku do të kryhet ekzekutimi dhe për dijeni drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit.

7. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të marrë informacione me interes për strukturat e Policisë së Shtetit, për të cilat ka detyrimin që të ruajë konfidencialitetin e këtyre të dhënave dhe nuk duhet t'ua japë këto informacione të tretëve, përveç rasteve të lejuara në përputhje me nenin 27, të ligjit nr. 8/2023, "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror".

III. RREGULLA DHE PROCEDURA QË NDIQET NGA POLICIA E SHTETIT PËR BASHKËPUNIMIN ME PËRMBARUESIT GJYQËSORË SHTETËRORË

1. Në rastet e paraqitjes së kërkesës për mbështetje, prezencë ose ndihmë nga ana e përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë, strukturat vendore të Policisë së Shtetit ndjekin rregullat dhe procedurat e mëposhtme:

1.1 Regjistrojnë dhe administrojnë menjëherë kërkesën e dërguar nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror;

1.2 Shqyrtojnë kërkesën për mbështetje, prezencë ose ndihmë të përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë dhe dokumentet shoqëruese të kërkesës, duke vepruar si më poshtë:

a) në rast të konstatimit të mangësisë në dokumentacionin e paraqitur sipas kreut II të këtij udhëzimi, kërkojnë nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror plotësimin e tij sa më shpejt të jetë e mundur;

b) kryejnë veprime për verifikimin e rrethanave lidhur me rrezikun, vështirësitë apo pengesat aktuale ose të mundshme gjatë procedurave përmbarimore, duke shfrytëzuar informacionet që disponojnë, si dhe mund të realizojnë takime paraprake me përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë.

1.3 Marrin masat e nevojshme për të garantuar dhe ofruar sigurinë fizike të përmbaruesit gjyqësor shtetëror dhe/ose personave që e shoqërojnë atë në ndihmë dhe gjatë kryerjes së veprimit përmbarimor në ditën, orën dhe vendin e caktuar në kërkesën zyrtare, si dhe sigurojnë:

a) mosçenimin e procesit përmbarimor nga pengesat e debitorit, personit të barazuar me të ose personit të tretë;

b) mbështetjen në terren dhe ofrimin e ndihmës me veprime konkrete përmbaruesit gjyqësor shtetëror;

c) evidentimin e rasteve kur përmbaruesi gjyqësor shtetëror kërcënohet, ose ndaj tij ushtrohet dhunë verbale a fizike;

ç) evidentimin e çdo ndërhyrjeje apo shkelje ligjore që mund të kryhet nga palët, personat që asistojnë apo janë të pranishëm, të cilët nuk janë lejuar nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror.

2. Policia e Shtetit përgjigjet jo më vonë se 3 (tri) ditë nga marrja e kërkesës për mbështetje, prezencë ose ndihmë ndaj përmbaruesit gjyqësor shtetëror, me përjashtim të rasteve kur kërkesa çmohet se paraqet një urgjencë dhe rrezikshmëri të veçantë për jetën dhe shëndetin e përmbaruesit gjyqësor shtetëror. Në këto raste prezenca, ndihma apo mbështetja duhet të jetë e menjëhershme.

3. Në rastet e pamundësisë funksionale dhe operative të Policisë së Shtetit për shkaqe madhore apo të një rëndësie të veçantë, për të mbështetur, ndihmuar dhe qenë prezent në ditën dhe kohën e kërkuar nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror, strukturat e Policisë së Shtetit e njoftojnë atë me shkrim apo me një mjet tjetër komunikimi (të dhënë si mënyrë alternative komunikimi nga përmbaruesi në kërkesën e tij), të paktën 48 (dyzet e tetë) orë para datës dhe orës së caktuar për ekzekutim, duke argumentuar arsyen e mosbashkëpunimit. Në këto raste, strukturat e Policisë së Shtetit i kërkojnë



përmbaruesit gjyqësor shtetëror, kur është e mundur, shtyrjen e orës apo datës në të cilën kërkohet mbështetja, prezenca ose ndihma e tyre.

4. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror pas kryerjes së veprimit përmbarimor në prezencë të punonjësit të Policisë së Shtetit, përpilon procesverbalin e kryerjes së veprimit përmbarimor, i cili nënshkruhet nga palët prezente dhe punonjësi i Policisë së Shtetit. Një kopje e procesverbalit të vulosur me vulën e përmbaruesit gjyqësor shtetëror i dorëzohet punonjësit të Policisë së Shtetit.

IV. RREGULLA DHE PROCEDURA TË PËRBASHKËTA

1. Nëse përmbaruesi gjyqësor shtetëror konstaton se strukturat e Policisë së Shtetit bëhen pengesë për realizimin e procesit përmbarimor nëpërmjet moszbatimit të parashikimeve të këtij udhëzimi, drejtohet menjëherë në Drejtorinë Vendore të Policisë së Shtetit, duke vënë në dijeni drejtorin e përgjithshëm të Përmbarimit dhe drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Palët në nivel qendror dhe në atë vendor informojnë reciprokisht njëra-tjetrën për situatat problematike që mund të ndodhin apo që shqetësojnë e pengojnë bashkëpunimin, me qëllim evidentimin e tyre dhe marrjen e masave parandaluese/eliminuese, si dhe ekzekutimin e titujve ekzekutivë në përputhje me ligjin. Për këtë qëllim, palët mund të organizojnë dhe zhvillojnë takime të përbashkëta.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit dhe Policia e Shtetit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA JELLA DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 7564/07)

VENDIM
STRASBURG
5 mars 2024

Ky është vendim përfundimtar, por mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Në çështjen Jella dhe të tjerë kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komiteti i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *President*,

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit*,

duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 7564/07) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa"), më 30 janar 2007 nga pesë shtetas shqiptarë ("kërkuesit") të përfaqësuar nga znj. E. Kurteshi dhe z. B. Boçari, avokatë të licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar për kërkesën Qeverinë e Shqipërisë ("Qeveria") të përfaqësuar nga agentja në atë kohë znj. E. Hajro, dhe më pas nga agjenti z. O. Moçka, avokat i përgjithshëm i shtetit;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 6 shkurt 2024,

merr vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në atë datë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me shkeljen e pretenduar të së drejtës së kërkuesve për gëzimin paqësor të pasurisë së tyre sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës për shkak të mosekzekutimit të vendimeve të brendshme në favor të tyre.

2. Lista e kërkuesve dhe të dhënat e tyre janë paraqitur në shtojcë.



I. PROCESET NË LIDHJE ME KTHIMIN E TOKËS

3. Toka e paraardhësve të kërkuesve u shtetëzua në një datë të papërcaktuar nga ish-regjimi komunist. Pas rënies së komunizmit, në një datë të papërcaktuar, kërkuesit depozituan një kërkesë pranë Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (“Komisioni”), me anë të së cilës kërkonin kthimin e parcelës së tokës në fjalë.

4. Më 9 shtator 1994, Komisioni njohu titullin e pronësisë së kërkuesve për një parcelë toke me sipërfaqe 43,100 metër katrorë (m²), nga të cilat 25,540 m² ishin të zëna. Ai vendosi që 13,310 m² që ndodhej brenda parcelës së lirë me sipërfaqe 17,560 m², t'i kthehej kërkuesve. Kërkuesit duhej të zgjidhnin vendndodhjen e kësaj sipërfaqeje 13,310 m². Ky vendim nuk u kundërshtua asnjëherë në asnjë gjykatë dhe është ende në fuqi. Deri më sot, kjo parcelë toke nuk është në posedim të kërkuesve dhe as nuk është regjistruar në emër të tyre.

5. Gjithashtu, Komisioni vendosi të rivendoste të drejtat e pronës së kërkuesve mbi një shtëpi së bashku me parcelën e tokës ngjitur me sipërfaqe 430 m² dhe një parcelë tjetër toke me sipërfaqe 400 m², që ndodhej brenda parcelës me sipërfaqe 43,100 m². Pronësia e kërkuesve mbi këto parcela u regjistrua në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

6. Në një datë të papërcaktuar, kërkuesit ngritën padi kundër Komisionit, duke kërkuar sqarimin e vendimit të tij në lidhje me njohjen e titullit të pronësisë, si edhe kthimin dhe/ose kompensimin e saj. Ndër të tjera, kërkuesit pretenduan se atyre duhej t'u ishte kthyer një parcelë toke me sipërfaqe 290,700 m². Më 17 maj 2005, Gjykata e Rrethit Tiranë rrëzoi padinë, duke pranuar pretendimin e Komisionit se kjo ishte një çështje e juridiksionit administrativ. Ky vendim mori formë të prerë.

7. Në vitin 2005 dhe në vitin 2007, kërkuesit paraqitën kërkesa pranë pasuesit të Komisionit, Agjencisë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (“Agjencia”), me anë të të cilave kërkuan që parcela me sipërfaqe 13,310 m² të kufizohej dhe të kthehej toka e mbetur e lirë. Më 26 qershor 2007, Agjencia i udhëzoi kërkuesit që të dorëzonin një kërkesë të re pranë zyrës së saj vendore.

8. Kundërshtimi i asaj shkrese nga kërkuesit u hodh poshtë nga drejtuesi i Agjencisë. Më 24 dhjetor 2009, Gjykata e Rrethit Tiranë vendosi në favor të kërkuesve, ku u shpreh se Agjencia e kishte për

detyrë të jepte një vendim. Ky vendim mori formë të prerë.

9. Më 25 tetor 2011, Agjencia refuzoi kërkesën e kërkuesve për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të datës 24 dhjetor 2009, me arsyetimin se u takonte kërkuesve të zgjidhnin vendndodhjen e saktë të parcelës së tokës. Agjencia gjithashtu pretendoi se nuk kishte kompetencë të shqyrtonte një vendim të Komisionit dhe kërkuesit duhej të depozitonin një padi civile.

10. Në vitin 2015, padia civile e kërkuesve u rrëzua nga Gjykata e Rrethit Tiranë, e cila nuk gjeti prova bindëse në lidhje me të drejtën e pronësisë së kërkuesve mbi parcelën e tokës me sipërfaqe 13,310 m². Në vitin 2017, Gjykata e Apelit Tiranë e prishi atë vendim dhe e ktheu çështjen në Gjykatën e Rrethit, duke u shprehur se analiza e provave përkatëse ishte e paplotë dhe se Agjencia nuk kishte vënë në pikëpyetje pronësinë e kërkuesve mbi parcelën e tokës me sipërfaqe 13,310 m². Në vitin 2023, çështja mbeti në pritje në Gjykatën e Lartë pas ankimit nga Agjencia për çështje të ligjit.

11. Më 11 korrik 2018, kërkuesit depozituan një kërkesë të re në Regjistrin e Tokave për regjistrimin e pronësisë së tyre mbi parcelën e tokës me sipërfaqe 13,310 m². Kërkesa u refuzua me arsyetimin se planimetria e pronës nuk i përcaktonte qartë kufijtë e asaj parcele toke.

II. PROCESET GJYQËSORE ME PALË PRIVATE

12. Më 6 shtator 1996, Komisioni njohu të drejtat e pronës në favor të një pale private, familjes S., për një parcelë toke. Në një datë të papërcaktuar, kërkuesit kundërshtuan vendimin e Komisionit, me pretendimin se parcela e tokës e S. ishte e mbivendosur me parcelën e tokës së tyre.

13. Më 19 maj 2004, Gjykata e Rrethit Tiranë anuloi pjesërisht vendimin e Komisionit të datës 6 shtator 1996, në lidhje me parcelën e tokës me sipërfaqe 5500 m² që mbivendosej me pronën e kërkuesve. Ky vendim mori formë të prerë më 27 dhjetor 2006, pas rrëzimit të kërkesës së të paditurit nga Gjykata e Lartë.

14. Më 17 tetor 2011, Gjykata e Rrethit rrëzoi një kërkesë të paraqitur nga kërkuesit kundër disa palëve private në lidhje me një mbivendosje tjetër me parcelën me sipërfaqe 13,310 m², duke konstatuar se në kohën e vendimit të Komisionit në vitin 1994 (shih paragrafin 4 më lart), parcela e tokës në fjalë ishte e zënë pjesërisht nga Z. B.



VLERËSIMI I GJYKATËS

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1

A. Pranueshmëria

15. Qeveria e kundërshtoi pranueshmërinë e kësaj ankese për dy arsye.

16. Së pari, ata pretenduan se ankesa e kërkuësve ishte jashtë objektit të nenit 1 të protokollit nr. 1 sepse ata nuk kishin pritshmëri legjitime për të fituar posedimin e parcelës së tokës me sipërfaqe 290.700 m² sa kohë që të drejtat mbi atë parcelë toke nuk ishin njohur me vendim të formës së prerë.

17. Gjykata thekson se një kërkuës mund të pretendojë shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 vetëm në masën që vendimet e kundërshtuara kanë të bëjnë me “pasuritë” e tij ose të saj sipas kuptimit të kësaj dispozite (shihni, ndër të tjera, *Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09, § 92, 31 korrik 2012, dhe *Luli dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09 dhe 5 të tjerë, § 104, 1 prill 2014). Për parcelën me sipërfaqe 290,700 m² ende nuk është marrë asnjë vendim përfundimtar i ekzekutueshëm. Proceset në lidhje me njohjen e të drejtave të pronës së kërkuësve mbi atë parcelë toke janë ende në pritje përpara autoriteteve të brendshme (shihni paragrafin 10 më lart).

18. Nga kjo vijon se kjo ankese është e papajtueshme *ratione materiae* me dispozitat e Konventës sipas kuptimit të paragrafit 3 të nenit 35, dhe duhet të refuzohet në përputhje me paragrafin 4, të nenit 35 të Konventës.

19. Për sa i përket parcelës me sipërfaqe 13,310 m², Gjykata vëren se kërkuësve u është njohur e drejta e kthimit me vendimin e Komisionit të vitit 1994, i cili është përfundimtar. Prandaj, ajo e konsideron pretendimin e kërkuësve mbi atë parcelë toke të provuar mjaftueshëm në legjislacionin e brendshëm për t’u cilësuar si “pasuri” e ekzekutueshme sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 (shihni, për shembull, *Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 38222 /02, § 71, 13 nëntor 2007).

20. Gjithashtu, Qeveria ftoi Gjykatën që të refuzojë kërkesën me arsyetimin se kërkuësit nuk i kishin shteruar mjetet juridike të brendshme, sepse ata duhej ta kishin adresuar çështjen në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Gjykata vëren se kërkuësit kanë nisur disa procese, duke përfshirë edhe me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për t’u ankuar në lidhje me

mosekzekutimin nga autoritetet të vendimit të Komisionit. Prandaj, dhe pa cenuar pyetjen e efektivitetit të mjeteve juridike të pretenduara, kundërshtimi i Qeverisë në lidhje me kërkesën e shterimit të mjeteve juridike të brendshme duhet të rrëzohet.

21. Gjykata vëren se kjo ankese nuk është e papranueshme për asnjë arsye tjetër dhe se, për rrjedhojë, ajo duhet të shpallet e pranueshme.

A. Themeli

22. Gjykata ka gjetur tashmë shkelje të ngjashme të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës në çështje të tjera në lidhje me vonesat në ekzekutimin e vendimeve administrative të formës së prerë për pronësinë në lidhje me Shtetin e paditur (shihni, mes vendimeve të tjera, *Ramadhi dhe të tjerë*, cituar më lart, §§ 45–53 dhe 75–84; *Hamzarakaj kundër Shqipërisë* (nr. 1), nr. 45264/04, §§ 24–27 dhe 38–43, 3 shkurt 2009; dhe *Nuri kundër Shqipërisë*, nr. 12306/04, §§ 26–29 dhe 35 40, 3 shkurt 2009). Prandaj, do të shqyrtojë nëse Qeveria ka bërë parashtresa të reja dhe relevante në çështjen në fjalë.

23. Qeveria parashtroi se kërkuësit, duke mos bashkëpunuar me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe duke mos respektuar proceset ligjore përkatëse, kishin penguar zbatimin e të drejtave të tyre të pronës. Gjykata nuk e gjen këtë argument bindës, duke pasur parasysh se shkak kryesor i mosekzekutimit ka qenë mungesa e kufijve të pronës në vendimin fillestar të Komisionit (shihni paragrafët 4, 7 dhe 11).

24. Rreziku i çdo gabimi të bërë nga një autoritet shtetëror duhet të përballohet nga Shteti dhe gabimet nuk duhet të korrigjohen në kurriz të personit të interesuar (shihni *Lelas kundër Kroacisë*, nr. 55555/08, § 74, 20 maj 2010). Në çështjen konkrete, kërkuësit filluan disa procese kundër palëve të treta ose autoriteteve publike për të mbrojtur dhe për të zbatuar të drejtat e tyre të pronës. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, deri tani vendimi nuk është ekzekutuar. Gjykata vlerëson se detyrimi i Shtetit për t’u siguruar në mënyrë efektive kërkuësve të drejtën e tyre për gëzimin paqësor të pasurisë së tyre, siç e garanton neni 1 i protokollit nr. 1 kërkon që autoritetet kombëtare të ndërmarrin hapa praktikë për të siguruar ekzekutimin e vendimit të tyre në lidhje me kthimin e pronësisë. Nuk duket se janë ndërmarrë këto hapa, pavarësisht përpjekjeve të kërkuësve (shihni *Nuri*, cituar më lart, § 28).



25. Gjykata vlerëson se autoritetet kombëtare, duke mos i ekzekutuar vendimet e Komisionit të vitit 1994, pa ndonjë arsye bindëse, i lanë kërkuessit në një gjendje pasigurie për 29 vjet deri tani, në lidhje me realizimin e të drejtave të tyre të pronës. Për më tepër, Gjykata vëren se Qeveria nuk ka pretenduar që kërkuessit nuk kanë ndërmarrë asnjë hap sipas ligjit nr. 133/2015 (ligji i pronës) (krahasoni *Beshiri dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 29026/06 dhe 11 kërkesa të tjera, §§ 216–18, 17 mars 2020).

26. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuessit duhej të mbanin një barrë joproporcionale dhe të tepruar. Në këto rrethana, konstatohet shkelje e nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 14

27. Kërkuessit paraqitën një ankesë sipas nenit 14 të Konventës me pretendimin se ata janë diskriminuar për gëzimin e të drejtave të tyre të pronës.

28. Gjykata nuk gjen asnjë të dhënë që kërkuessit të jenë diskriminuar për ndonjë nga shkaqet sipas nenit 14 të Konventës. Prandaj, kjo ankesë është qartazi e pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me paragrafët 3 (a) dhe 4 të nenit 35 të Konventës.

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

29. Kërkuessit pretenduan 810,579 euro (EUR) që korresponduan me vlerën e pronës, si dhe 533,326 euro për humbje fitimi. Ata kërkuan 20,000 EUR për dëmin jopasuror. Në fund, ata kërkuan 4,770 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra për gjykatat e brendshme dhe për ato të bëra për Gjykatën.

30. Qeveria parashtroi se hartat e vlerës së pronave bazuar në VKM-në nr. 139 të 13 shkurtit 2008 jepnin çmime më të ulëta.

31. Së pari, Gjykata vëren se, pavarësisht pranimi nga ana e Qeverisë që një pjesë e parcelës me sipërfaqe 17,560 m², ku duhej të kufizohej parcela e kërkuessve prej 13,310 m², ishte e zënë nga palë të treta, nuk ka asnjë informacion përfundimtar në lidhje me shtrirjen e kësaj sipërfaqeje të zënë.

32. Duke pasur parasysh gjetjet e saj në çështjen në fjalë, Gjykata vlerëson se forma më e përshtatshme e korrigjimit do të ishte përcaktimi i kufijve të parcelës së tokës dhe regjistrimi i titullit të pronësisë së kërkuessve (shihni paragrafët 24–25 më lart; shihni edhe *Ramadhi dhe të tjerë*, cituar më lart, §§ 98–101; *Tchitchinadze kundër Gjeorgjisë*, nr. 18156/05,

§ 69, 27 maj 2010; *Fener Rum Patrikligji (Ecumenical Patriarchy) kundër Turqisë* (shpërblimi i drejtë), nr. 14340/05, § 35, 15 qershor 2010; dhe *Stoycheva kundër Bullgarisë*, nr. 43590/04, §§ 75–76, 19 korrik 2011). Kështu, kërkuessit do të viheshin sa më shumë që të ishte e mundur në një situatë të njëjtë me atë ku do të kishin qenë nëse nuk do të ishin shkelur të drejtat e tyre sipas Konventës (krahasoni me *Gladysheva kundër Rusisë*, nr. 7097/10, § 106, 6 dhjetor 2011). Nëse Qeveria nuk mund të sigurojë këtë regjistrim, tërësisht ose pjesërisht, kërkuessit duhet të marrin kompensimin e duhur (krahasoni me *Brumărescu kundër Rumanisë* (shpërblimi i drejtë) [DHM], nr. 28342/95, §§ 19–24, GJEDNJ 2001 I, dhe shihni *Beshiri dhe të tjerët*, të cituar më lart, §§ 189–203, për vlerësimin e mjaftueshmërisë së kompensimit).

33. Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuessve për humbje fitimi duhet të refuzohet, pasi ata nuk arritën të shtjellonin këtë pretendim dhe të specifikonin llojin e fitimit që kishin humbur (krahasoni *Vrioni dhe të tjerët*, cituar më lart, § 38).

34. Gjykata pranon gjithashtu se kërkuessit duhet të kenë pësuar dëm jopasuror dhe e sheh me vend t'u caktojë atyre 3000 euro bashkërisht nën këtë zë, plus çdo taksë që mund të ngarkohet.

35. Në lidhje me kostot dhe shpenzimet për gjykatat e brendshme dhe Gjykatën, Gjykata refuzon pretendimin për kosto dhe shpenzime në procese gjyqësore të brendshme dhe e konsideron të arsyeshme të caktojë shumën 2000 EUR, së bashku, për proceset në Gjykatë, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuessve.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, ME UNANIMITET,

1. *shpall* të pranueshëm ankimin në lidhje me nenin 1 të protokollit nr. 1 për parcelën e tokës me sipërfaqe 13,310 m² dhe të papranueshëm pjesën tjetër të ankimit;

2. *vendos* se është shkelur neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës;

3. *vendos*,

a) që Shteti i paditur të sigurojë brenda tre muajve regjistrimin e titullit të pronësisë së kërkuessve. Nëse nuk bëhet regjistrimi, tërësisht ose pjesërisht, shteti i paditur t'i paguajë bashkërisht tre kërkuessve, brenda dymbëdhjetë muajve, kompensimin e duhur;



b) që Shteti i paditur t'i paguajë kërkesuesve bashkërisht, brenda tre muajve, shumat e mëposhtme, që do të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur me kursin e këmbimit në fuqi në datën e shlyerjes:

i. 3.000 euro (tre mijë euro) për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund t'u ngarkohet;

ii. 2.000 euro (dy mijë euro) për kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund t'u ngarkohet kërkesuesve;

c) nga mbarimi i afatit tre mujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, interes i thjeshtë të

paguhet për shumat e mësipërme sipas normës të njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tri pikë përqindje;

4. *rrezon* pjesën tjetër të kërkesës së kërkesuesve për kompensim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 5 mars 2024 sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
Zëvendëskancelare

Georgios A. Serghides
President

SHTOJÇË

Lista e kërkesuesve:

Kërkesa nr. 7564/07

Nr.	Emri i kërkesuesit	Viti i lindjes/regjistrimit	Shtetësia	Vendi i qëndrimit
1	Ilir JELLA	1971	shqiptar	Tiranë
2	Firdes ÇIÇIKU	1946	shqiptare	Tiranë
3	Besnik JELLA	1975	shqiptar	Tiranë
4	Zamira JELLA	1957	shqiptare	Tiranë
5	Xhemali NOVA	1949	shqiptar	Tiranë

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 21141/20

VALBONA BALA KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 9 prill 2024, si një Dhomë e përbërë nga:

Pere Pastor Vilanova, *kryetar*,

Jolien Schukking,

Georgios A. Serghides,

Darian Pavli,

Peeter Roosma,

Ioannis Ktistakis,

Andreas Zünd, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendësekretare e Seksionit*, duke mbajtur në konsideratë kërkesën e mësipërme të depozituar më 22 maj 2020,

duke mbajtur në konsideratë deklaratat e paraqitura nga qeveria e paditur dhe deklaratat e paraqitura nga kërkesja si përgjigje ndaj të parave, pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

HYRJE

1. Çështja ka të bëjë me pretendimin për shkelje të nenit 8 të Konventës, në lidhje me ndalimin prej pesëmbëdhjetë vitesh të kërkeses për t'u emëruar në poste dhe detyra të caktuara në sistemin e drejtësisë, pas ndërprerjes së procedurave të *vetting*-ut (rivlerësimit kalimtar) për shkak të dorëheqjes së saj të mëparshme nga pozicioni si këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese.

FAKTE

2. Kërkesja, znj. Valbona Bala, është një shtetase shqiptare, lindur në vitin 1977, dhe banuese në Tiranë. Ajo u përfaqësua nga z. T. Eatwell, dhe më pas nga z. S. Powles, avokatë të cilët e ushtrojnë profesionin në Londër. Qeveria shqiptare u përfaqësua nga z. B. Lilo, dhe në vijim nga z. O. Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

3. Faktet e çështjes të paraqitura nga palët mund të përmbliken si në vijim.

4. Nga muaji prill 2008 deri më 30 prill 2017, kërkesja punoi si këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë.

5. Sipas ndryshimeve kushtetuese dhe legjislacionit të miratuar në vitin 2016, këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese do t'i nënshtroheshin procesit të rivlerësimit kalimtar ("procesi i *vetting*-ut") (shih *Xboxhaj kundër Shqipërisë*, nr.



15227/19, 9 shkurt 2021). Organet e *vetting*-ut – Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA) – u krijuan dhe u plotësuan me personel në qershor 2017; në shtator 2017, këto organe ishin në procesin e miratimit të rregulloreve të brendshme; çështja e parë e *vetting*-ut nisi në mars 2018.

6. Në dhjetor 2016, u hap pozicioni për një avokat të nivelit të lartë në një projekt të financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe në lidhje me çështje që kishin të bënin me zbatimin e reformës në drejtësi në Shqipëri.

7. Në janar 2017, kërkuesja paraqiti deklaratat e saj, në lidhje me tre komponentët e procesit të *vetting*-ut dhe i autorizoi autoritetet kompetente që të vijonin me verifikimet e nevojshme duke përfshirë përpunimin e të dhënave të saj personale.

8. Në një datë të papërcaktuar, kërkueses iu ofrua pozicioni i mësipërm në projektin e USAID-it. Më 3 mars 2017, ajo paraqiti dorëheqjen e saj përpara Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, dorëheqje që do të ishte në fuqi që prej datës 1 maj 2017. Dorëheqja e saj u pranua dhe ajo filloi punën e re, që ishte më e mirëpërgatitur dhe që vijoi deri në prill 2020 (shih paragrafin 19 më poshtë).

9. Rezulton se ndërkohë kërkuesja kishte aplikuar për t'u pranuar në Shkollën e Magjistraturës. Sipas dispozitave kalimtare të ligjit nr. 96/2016, këshilltarët ligjorë në Gjykatën Kushtetuese fituan të drejtën për t'iu nënshtruar procedurave testuese në Shkollën e Magjistraturës (shih paragrafin 31 në vijim). Gjatë fazës së parë të testimit, ajo mori 56 pikë nga 100, rezultat që ishte poshtë pragut të kërkuar prej 60%. Gjatë raundit të dytë, ajo mori 160 pikë nga 200 dhe u rendit e para ndër të gjithë këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë. Pavarësisht rezultatit, ajo nuk u regjistrua si kandidate magjistrate.

10. Pas publikimit të njoftimeve për pozicionet e fundit vakante në radhët e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese në shkurt dhe gusht 2018, kërkuesja shprehu interesin e saj dhe aplikoi.

11. Për shkak të aplikimit për një pozicion si gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, çështja e *vetting*-ut të kërkueses përfshihej në listën e çështjeve me prioritet *prima facie*, dhe, pas hedhjes së shorteve në maj 2018, çështja e saj u përzgjedh për t'u trajtuar me prioritet. Në maj 2018, KPK-ja nisi një hetim administrativ për kërkuesen për komponentët e

procesit të *vetting*-ut. Sipas rrethanave, ajo u vu në dijeni në qershor 2018.

12. Në qershor 2018, kërkuesja i kërkoi KPK-së që të sqaronte statusin e saj në procesin e *vetting*-ut, duke pasur në konsideratë faktin se ajo nuk shërbente më si këshilltarë ligjorë në Gjykatën Kushtetuese, dhe sipas këndvështrimit të saj, ajo nuk mund të ishte më subjekt i procesit të detyruar të *vetting*-ut për këtë aspekt. Gjithashtu, ajo nuk mund t'i nënshtrohej vullnetarisht procesit të *vetting*-ut pasi ajo nuk kishte kaluar me sukses provimin në Shkollën e Magjistraturës dhe sipas këtyre rrethanave, ajo nuk kishte kërkuar të rivlerësohej. Ajo u shpreh se qëllimi i saj nuk ishte të kundërshtonte procesin e *vetting*-ut që po zhvillohej ndaj saj.

13. Me anë të një vendimi të datës 13 shtator 2018, KPK-ja ndërpreu procesin e *vetting*-ut për kërkuesen pasi nuk kishte më bazë ligjore për trajtimin e saj si “subjekt i rivlerësimit”, duke theksuar edhe faktin se ajo nuk kishte pasur sukses për t'u pranuar në Shkollën e Magjistraturës. Ky vendim u publikua në faqen e internetit të KPK-së dhe ajo u vu në dijeni.

14. Kërkuesja dhe Komisioneri Publik apeluan pranë KPA-së. Komisioneri Publik kërkoi prej KPA-së që të ndryshonte vendimin për ndërprerje, duke theksuar se në këtë mënyrë kërkueses i ndalohej që të emërohej në ndonjë nga postet dhe pozicionet në sistemin e drejtësisë të listuar në nenin G të aneksit të Kushtetutës (shih paragrafin 22 në vijim). Kërkuesja u ankua për mosmbajtjen e një seance dëgjimore pranë KPK-së, se një gjë e tillë nuk parashikohej në ligj dhe se nuk i ishte dhënë arsytimi i duhur, veçanërisht në lidhje me statusin e saj ligjor në procesin e *vetting*-ut dhe relevancës së nenit G. Gjithashtu, ajo argumentoi se ndalimi nuk do të ishte proporcional.

15. Në 25 korrik 2019, KPA-ja ndryshoi vendimin e KPK-së të datës 13 shtator 2018. Në pjesën operative, KPA-ja argumentonte se procesi i *vetting*-ut ishte ndërprerë, dhe se kërkuesja nuk mund të emërohej për pesëmbëdhjetë vite si gjyqtare ose prokurore në asnjë nivel, as si anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor apo e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si Inspektore e Lartë e Drejtësisë apo si Prokurore e Përgjithshme.

16. KPA-ja u shpreh si në vijim.

a) Kërkuesja e kishte paraqitur dorëheqjen e saj më 31 mars 2017, datë që përkonte me përfundimin



e afatit ligjor prej tre muajsh për regjistrim sipas nenit 56, të Ligjit për Rivlerësim (shih paragrafin 23 në vijim). Megjithatë, kjo dorëheqje ishte jashtë fushës së nenit 56, pasi ajo kishte shprehur qartazi vullnetin e saj për t'u dorëhequr duke nisur nga fundi i muajit prill 2017, dhe pasi ajo nuk kishte ndjekur procedurën e kërkuar sipas nenit 56. Për këtë arsye, ajo nuk kishte për qëllim që të kërkonte të drejtën e garantuar sipas asaj dispozite për përfitime të caktuara financiare.

b) Vullneti për të mosshmangur procesin e *vetting*-ut mund të shprehej vetëm duke qëndruar në detyrë dhe duke përfunduar procesin. Pasi kërkesja vendosi në mënyrë të lirë që të ndërpriste punësimin e saj në Gjykatën Kushtetuese, ajo do të duhej të merrte në konsideratë pasojat ligjore të dorëheqjes, sipas nenit G të aneksit të Kushtetutës. Pretendimi i saj se në komunikimin e saj me KPK-në ajo nuk kishte shprehur dëshirën për të shmangur procesin e *vetting*-ut, nuk mund të pranohet si arsye për të mosvendosur ndalimin prej pesëmbëdhjetë vitesh. Gjithashtu, pozicioni i saj në KPA – që ka të bëjë me pranimin e ndërprerjes së procedurave të *vetting*-ut sipas nenit G, teksa ajo kundërshtonte vendosjen e ndalimit sipas së njëjtës dispozite – “vinte në dyshim vullnetin real për të mosshmangur [procesin e *vetting*-ut]”. Si përgjigje ndaj argumentit të kërkeses për disproporcionalitetin e ndalimit, KPA-ja iu referua gjetjeve të bëra nga Gjykata Kushtetuese (shih paragrafin 24 më poshtë) dhe vlerësoi se nuk kishte juridiksionin për të bërë një vlerësim të tillë.

17. Kërkeses iu dha një tekst i shkurtuar i vendimit të KPA-së, më 26 korrik 2019. Asaj iu dha teksti i plotë më 22 tetor 2019. Vendimi u publikua në faqen e internetit të KPA-së.

18. Ndërkohë, në datën 30 korrik 2019, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KPE) vendosi të ndërpriste shqyrtimin e kandidaturës së kërkeses për një pozicion si gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese. Për sa kishte të bënte me ndalimin prej pesëmbëdhjetë vitesh, Këshilli iu referua gjetjeve të KPA-së.

19. Sipas CV-së së kërkeses rezultoi se ajo është anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë, ka pasur funksionin si eksperte/moderatore për trajnimin e vazhdueshëm të magistratëve, dhe profesore e jashtme në kursin e trajnimit fillestar organizuar nga Shkolla e Magistraturës. Pas muajit prill 2020, ajo ndoqi aktivitete të tjera fitimprurëse, me të ardhura që ishin të krahasueshme me pozicionin e saj të

mëparshëm si këshilltare në Gjykatën Kushtetuese. Rezulton se së fundmi, ajo shërben në një pozicion drejtues pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

20. Kërkesja paraqiti përpara Gjykatës referenca të raportimeve të medias në lidhje me procesin e *vetting*-ut. Sipas raportimeve rezultoi se në vitin 2015, F. Xh., deputet në Parlament, i cili drejtonte Komisionin e Ligjeve dhe Komisionin për Reformën në Drejtësi, deklaronte se tridhjetë e pesë për qind e gjyqtarëve kishin pasuri me vlerë mbi 300,000 (EUR); ato pasuri ishin të pajustificuara dhe tregonin për nivelin e lartë të korrupsionit në gjyqësor; dhe se reforma në drejtësi duhej ta hiqte “atë kastë” nga sistemi. Në këto raportime të medias përmendeshin ose citoreshin deklarata për qëllimet e procesit të *vetting*-ut nga një përfaqësues i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, dhe nga një përfaqësues i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri në vitin 2019. Kërkesja i referohej edhe procesverbalit të një takimi të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi, në maj 2016, ku një prej folësve të ftuar përmendte se rregullorja e propozuar për dorëheqjen do të “hapë një derë për ata që dëshirojnë të largohen”, si edhe diskutimit në lidhje me dëshirën për t'i lejuar personat që do të vendosnin të dorëhiqeshin që të rihynin në sistemin e drejtësisë në një periudhë të mëvonshme. Së fundmi, kërkesja iu referua Komentarit të vitit 2016 për Reformën Kushtetuese në Sistemin e Drejtësisë pa paraqitur tekstin përkatës.

PRAKTIKA DHE KUADRI LIGJOR PËR-KATËS

A. Ndërprerja e procesit të *vetting*-ut dhe ndalimi për t'u emëruar në poste dhe detyra në sistemin e drejtësisë

21. Për dispozitat përkatëse të ligjit shqiptar për procesin e rivlerësimit kalimtar, shih *Xboxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, §§ 93–154, 9 shkurt 2021.

22. Neni 179/b i Kushtetutës parashikon se të gjithë këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë në gjykatat administrative dhe Prokurorinë e Përgjithshme duhej t'i nënshtroheshin procesit të *vetting*-ut në mbështetje të Ligjit për Rivlerësimin Kalimtar (ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”). Sipas nenit G të aneksit të Kushtetutës, një person që do t'i nënshtrohet rivlerësimit mund të dorëhiqet nga detyra, dhe në një rast të tillë procesi i *vetting*-ut në lidhje me këtë person



ndërpritet; një subjekt i rivlerësimit i cili është dorëhequr në mbështetje të këtij neni mund të mos emërohet për pesëmbëdhjetë vite si gjyqtar ose prokuror në cilindo nivel, si një anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm.

23. Neni 56 i Ligjit të *Vetting*-ut parashikon se një subjekti i rivlerësimit ka të drejtën të dorëhiqet brenda tre muajve nga hyrja në fuqi i këtij ligji dhe, në një rast të tillë, personi ka të drejtën të marrë një pagesë tranzitore. Dorëheqja duhet të dorëzohet me shkrim përpara Presidentit të Republikës. Në një rast të tillë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) duhet të lëshojë një vendim për ndërprerjen e procesit të *vetting*-ut.

24. Në vendimin nr. 78, të datës 12 dhjetor 2017, Gjykata Kushtetuese vendosi se neni 56 i Ligjit të *Vetting*-ut ishte kushtetues për atë kohë sa ai nuk i mohonte personit që do të rivlerësohej të drejtën për dorëheqje, një e drejtë e garantuar nga neni G i aneksit të Kushtetutës. Neni 56, i Ligjit të *Vetting*-ut i bën të mundur një personi i cili dorëhiqet që brenda një periudhe tremujore të kërkojë një pagesë tranzitore, sipas parashikimit ligjor në fuqi, një përfitim që nuk ishte i disponueshëm për personat që kanë dhënë dorëheqjen pas këtij afati. Gjykata Kushtetuese theksonte se për atë kohë sa personi qëndronte në detyrë dhe procesi i *vetting*-ut nuk kishte përfunduar ende, ai person kishte të drejtën të dorëhiqej dhe në një rast të tillë, procesi i *vetting*-ut do të ndërpritej, sipas parashikimit të nenit G të aneksit të Kushtetutës.

25. Në vendimin nr. 1, të datës 11 qershor 2018, KPA-ja vendosi si në vijim. Akti i dorëheqjes, i paraqitur rregullisht, përbën arsye për ndërprerjen e procedurave dhe për zbatimin e plotë të parashikimit kushtetues. Sakaq, sipas parashikimit në Kushtetutë (neni G i aneksit të saj), dorëheqja nuk është as shkak për shkarkim nga detyra për subjektin e rivlerësimit, dhe as shkak për konfirmimin në detyrë. Megjithatë, ushtrimi i së drejtës për dorëheqje shoqërohet me kufizimin e të drejtës së personit, një ndalim prej pesëmbëdhjetë vitesh për t'u emëruar në poste dhe detyra të caktuara. Në rastin kur KPK-ja ndërpret procedurat e rivlerësimit, ajo duhet të vendosë edhe për urdhërimin e atij ndalimi.

26. Pas nisjes së procedurave të rivlerësimit në vitin 2020, KPK-ja u vu në dijeni se A. H. kishte

dhënë dorëheqjen nga detyra si gjyqtar në vitin 2019. Në vijim, KPA-ja gjykoi se edhe nëse mendohej se ai kishte dhënë dorëheqjen për shkak të situatës së tij shëndetësore dhe se kjo gjendje shëndetësore nuk e lejonte që të vijonte të shërbente si gjyqtar, këto vlerësime nuk kishin lidhje me shqyrtimin e vendimit të KPK-së, për të ndërprerë procesin dhe për të urdhëruar ndalimin e përmendur më sipër prej pesëmbëdhjetë vitesh. Gjithashtu, u theksua se ligji nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve", parashikonte mundësinë për të pezulluar një gjyqtar nga ushtrimi i detyrave gjyqësore për arsye shëndetësore, teksa vijonte të mbante statusin e gjyqtarit. Rekursi ndaj kësaj mundësie mund të kishte shmangur ndërprerjen e procedurave dhe ndalimin sipas nenit G të aneksit të Kushtetutës. Ky ndalim nuk mund të ishte disproporcional, pasi përcaktohej nga një dispozitë kushtetuese si pasojë e detyrueshme e dorëheqjes nga detyra në një kontekst përjashtimor të rivlerësimit që zhvillohej vetëm një herë për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në vend. Organet e *vetting*-ut nuk kishin diskrecion për të mos zbatuar atë ndalim ose për të ndryshuar kohëzgjatjen e tij (vendimi i KPA-së nr. 42/2020).

27. Në nëntor 2023, KPK-ja kishte marrë 101 vendime për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të aneksit të Kushtetutës, për gjashtëdhjetë gjyqtarë, njëzet e shtatë prokurorë, dymbëdhjetë ndihmës ligjorë, këshilltarë ligjorë dhe disa të tjerë; dhe tetë vendime për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit sipas nenit 56 të Ligjit të Rivlerësimit për tre gjyqtarë, një prokuror dhe katër këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë.

B. Përzgjedhja dhe kriteret përzgjedhëse, dhe procedurat për postet dhe pozicionet përkatëse

1. Postet për kandidatët "magjistratë" (me anë të Shkollës së Magjistraturës)

28. Pjesa IX e Kushtetutës, me titullin "Gjykata", ka të bëjë me sistemin gjyqësor të përbërë nga Gjykata e Lartë, gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit. Pjesa IX, neni 136/a parashikon se një "gjyqtar" mund të jetë një shtetas shqiptar i emëruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor pas diplomimit nga Shkolla e Magjistraturës dhe pas përfundimit të procesit paraprak të verifikimit të pasurisë dhe të kontrollit të figurës, sipas ligjit. Sipas nenit 147/a të Kushtetutës (edhe sipas pjesës IX të



Kushtetutës), Këshilli i Lartë Gjyqësor emëron gjyqtarët “në të gjitha nivelet”.

29. Neni 2, i ligjit nr. 96/2016, përkufizon termin “magjistratë” si gjyqtarë, përveç gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, dhe prokurorëve. Neni 2, i ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” përkufizon “sistemin gjyqësor” si të përbërë nga të gjitha gjykatat, me përjashtim të Gjykatës Kushtetuese, dhe organeve qeverisëse të gjyqësorit.

30. Sipas nenit 244, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet qeverisëse të sistemit të drejtësisë”, Shkolla e Magjistraturës ofron arsimimin profesional të magjistratëve, që përfshin trajnimin fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për t’u pranuar, aplikuesit i nënshtrohen një konkursi, njohuritë e tyre testohen, dhe integriteti i tyre i nënshtrohet verifikimit (neni 266). Faza e parë është e një natyre cilësuese, dhe në rastin e aplikuesve të suksesshëm, ajo ndiqet nga një fazë e dytë me shkrim për shqyrtim. Kandidatët që janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, caktohen magjistratë pas përfundimit me sukses të trajnimit fillestar (neni 271).

31. Sipas nenit 28, të ligjit nr. 96/2016, çdo shtetas shqiptar që përmbush kritere të caktuara të përzgjedhjes ka të drejtën të aplikojë në Shkollën e Magjistraturës për pranim në trajnimin fillestar si magjistrat. Nuk rezulton se ekziston një kufi maksimal moshe, apo limit në lidhje me numrin se sa herë mund të aplikojë një person. Për sa i përket specifikisht këshilltarëve ligjorë në Gjykatën Kushtetuese dhe disa zyrtarëve të tjerë në pozicione të ngjashme, të cilët janë subjekt i procesit të *vetting*-ut, sipas Ligjit të *Vetting*-ut, ata kanë të drejtën – nëse kanë marrë të paktën 60% të pikëve në testin e njohurive profesionale në Shkollën e Magjistraturës dhe kalojnë testin e dytë – të pranohen në Shkollën e Magjistraturës (seksioni 165). Në rastin kur organet e *vetting*-ut kanë lëshuar një vendim për shkarkimin nga detyra, trajnimi i personit ndërpritet (shih edhe seksionet 10, 22 dhe 25 të vitit 2017, të Rregullores së Brendshme të Shkollës së magjistraturës).

2. *Pozicionet e larta të arritshme për kandidatët “jo magjistratë”*

a) Në sistemet gjyqësore dhe të prokurorisë

i. *Pozicioni i gjyqtarit pranë Gjykatës së Lartë*

32. Sipas nenit 136 të Kushtetutës, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë përzgjidhen nga radhët e gjyqtarëve të karrierës me të paktën trembëdhjetë

vite eksperiencë. Një e pesta e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë përzgjidhen midis juristëve të spikatur me jo më pak se pesëmbëdhjetë vite eksperiencë si avokatë, profesorë të drejtësisë, lektorë të drejtësisë ose avokatë të nivelit të lartë në administratën publike ose fusha të tjera të drejtësisë. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen për një mandat të vetëm nëntëvjeçar nga Presidenti i Republikës me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

33. Rezulton se pas procedurave përzgjedhëse në vitin 2019 dhe në vijim, katër nga tetëmbëdhjetë gjyqtarët aktual në Gjykatën e Lartë janë përzgjedhur nga radhët e juristëve të spikatur.

ii. *Prokurori i Përgjithshëm*

34. Sipas nenit 148/a të Kushtetutës, Prokurori i Përgjithshëm përzgjidhet për një mandat të vetëm shtatëvjeçar nga një shumicë prej një të pestash midis anëtarëve të Parlamentit, nga një listë prej tre kandidatësh të propozuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Këshilli duhet të përzgjedhë dhe të rendis tre kandidatët më të kualifikuar dhe t’ia përcjellë atë listë Parlamentit. Prokurori i Përgjithshëm duhet të përzgjidhet nga radhët e juristëve të spikatur me të paktën pesëmbëdhjetë vite eksperiencë profesionale, me moral të lartë dhe integritet profesional, i/e diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës, ose të ketë diplomë akademike/shkencore në drejtësi. Kandidatët duhet të kalojnë vlerësimin për pasurinë dhe figurën, dhe të mos kenë masë disiplinore në fuqi (neni 22, i ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”).

iii. *Përbërja e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë*

35. Sipas nenit 147 të Kushtetutës dhe neneve 4 dhe 19–58, të ligjit nr. 115/2016, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shtatë anëtarë që shërbejnë me kohë të plotë për pesë vite. Gjashtë anëtarë janë gjyqtarë karriere dhe përzgjidhen nga “gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor”. Pesë të tjerët janë “anëtarë jo gjyqtarë” të përzgjedhur nga Parlamenti, me një shumicë prej dy të tretash të të gjithë anëtarëve të tij: dy nga radhët e avokatëve në detyrë, dy nga radhët e lektorëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, dhe një nga radhët e përfaqësuesve të shoqërisë civile. Kandidatët laik i nënshtrohen një vlerësimi paraprak të pajtueshmërisë së tyre me një sërë kushtesh dhe kriteresh ligjore (duke përfshirë një eksperiencë profesionale minimalisht prej pesëmbëdhjetë



vitesh), vlerësimi paraprak të integritetit të tyre moral dhe profesional, dhe një mekanizmi filtrues të kandidaturave.

36. Rregulla të ngjashme shkojnë edhe për përbërjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë (nenet 101 dhe 117-56, të ligjit nr. 115/2016).

in. Inspektori i Lartë i Drejtësisë

37. Sipas nenit 147/d të Kushtetutës, një shtetas shqiptar mund të përzgjidhet si Inspektor i Lartë i Drejtësisë për një periudhë të vetme nëntëvjeçare, nëse ky person përmbush kritere të caktuara përzgjedhjeje, të tilla si pesëmbëdhjetë vite eksperiencë profesionale si jurist i spikatur dhe të jetë një person me moral të lartë dhe integritet profesional. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i vlerëson kandidatët sipas kriterëve statutorë të vlerësimit, rendit kandidatët dhe paraqet një raport në Parlament, që më pas përzgjedh Inspektorin e Lartë të Drejtësisë me një shumicë prej tre të pestash të anëtarëve të tij.

38. Ky pozicion u plotësua në janar 2020 dhe që prej këtij momenti nuk ka qenë i lirë.

b) Përbërja me gjyqtarë i Gjykatës Kushtetuese

39. Pjesa VIII e Kushtetutës ka të bëjë me Gjykatën Kushtetuese dhe anëtarët e saj. Neni 125 i Kushtetutës parashikon se tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë përzgjidhen nga Parlamenti (me një shumicë prej tre të pestash të të gjithë anëtarëve të tij) dhe tre anëtarë përzgjidhen nga Gjykata e Lartë. Gjyqtarët caktohen nga një listë ku tre të parët janë të përzgjedhurit. Renditja bëhet nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi për secilën vakancë. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë një arsim më të lartë në drejtësi, të paktën pesëmbëdhjetë vite eksperiencë profesionale, si: gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të drejtësisë, ose nëpunës civilë të lartë në administratën publike, me një aktivitet të spikatur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në fusha të tjera të drejtësisë. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese shërbejnë për një mandat nëntëvjeçar.

40. Sipas vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, të datës 11 mars 2019, për verifikimin e kandidatëve për vakancat në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, kandidatët magistratë dhe persona të tjerë subjekte të procesit të rivlerësimit sipas Ligjit të Rivlerësimit, të cilët nuk janë konfirmuar përfundimisht

misht në detyrë nga organet e *vetting*-ut, nuk lejohen të kandidojnë për pozicionet përkatëse (paragrafi 111).

ANKESA

41. Kërkuesja u ankua se pas ndërprerjes së procedurave të rivlerësimit për të, asaj iu ndalua të emërohej si pjesë e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, si edhe në disa pozicione dhe poste në sistemin e drejtësisë, dhe se vuajti një humbje të reputacionit në shkellje të nenit 8 të Konventës.

LIGJI

42. Pjesët përkatëse të nenit 8 të Konventës parashikojnë si në vijim:

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, ...

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, ...”.

A. Parashtrimet e palëve

1. Qeveria

43. Qeveria deklaroi se KPA-ja ishte shprehur për pjesën operative të vendimit të saj, më 25 korrik 2019, një vit më pas kërkueses i ishte dhënë versioni i shkurtër i tekstit, dhe ajo e kishte marrë tekstin e plotë më 22 tetor 2019. Kërkesa pranë Gjykatës ishte depozituar më 22 maj 2020. Ajo nuk kishte shteruar mjetet vendase sepse ajo nuk kishte kërkuar një shqyrtim gjyqësor të vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të datës 30 korrik 2019, përpara Gjykatës Administrative të Apelit (shih paragrafin 18 më sipër). Neni G i aneksit të Kushtetutës parashikonte një shkellje gjatë emërimit të një gjyqtari në një gjykatë me përjashtim të Gjykatës Kushtetuese. Për këtë arsye, ishte vendimi i datës 30 korrik 2019 – dhe jo vendimi i KPA-së që e vendoste atë ndalim – që i jepte fund kandidurës së saj në Gjykatën Kushtetuese.

44. Qeveria argumentoi se ankesa ishte e papajtueshme *ratione materiae*. Ndërprerja e procedurave të *vetting*-ut nuk ndikonte rrethim e brendshëm të kërkueses dhe nuk kishte pasoja për marrëdhënien e saj të punësimit me Gjykatën Kushtetuese ose për punën e saj në sektorin privat; të ardhurat e saj nuk ndikoheshin. Për sa i përket ndalimit prej pesëmbëdhjetë vitesh, neni 8 i Konventës nuk garantonte asnjë të drejtë për punësimin ose për të aplikuar për një vakancë në gjyqësor. Vendimi për ndërprerjen nuk kishte asnjë efekt negativ në aftësinë e saj për të ndërtuar



marrëdhënie në shoqëri apo në vendin e punës, apo në reputacionin e saj. Ndërrerja nuk shoqërohej me sanksione të drejtpërdrejta. Gjatë procesit të rivlerësimit nuk ishte mbyllur asnjë hetim. Në media nuk ishte publikuar asnjë informacion për komponentët e procesit të rivlerësimit. Vendimet e marra nga organet e rivlerësimit nuk përmbanin asnjë deklaratë për vlerat morale të kërkueses. Ndërrerja e procedurave kishte ardhur si pasojë e zgjedhjes së saj për të dhënë dorëheqjen.

45. Vendimi i KPA-së nuk e ndalonte kërkuesen që të bëhej një gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese pasi, në çdo rast, neni G i aneksit të Kushtetutës nuk pengonte aksesin për t'u bërë një prej gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Për sa i përket posteve ose pozicioneve të tjera në sistemin e drejtësisë të listuara në nenin G, kërkuesja nuk përmbushte kërkesat respektive për t'u përzgjedhur. Ajo nuk kishte kaluar provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës dhe nuk kishte fituar titullin e “magjistratit”. Për këtë arsye, ajo nuk mund të ushtronte funksione në gjyqësor ose në prokurori në cilindo nivel, dhe nuk mund të bëhej anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, pasi anëtarët e tyre nominohen nga radhët e “magjistratëve”. Ajo nuk mund të bëhej as anëtare jo gjyqtare në këta Këshilla, pasi nuk kishte eksperiencën përkatëse profesionale për kandidatura të tilla. Për këtë arsye, ndalimi i vendosur nga KPA-ja ishte deklarativ dhe nuk ndikonte në të vërtetë jetën e saj profesionale.

46. Ndalimi sipas nenit G i aneksit të Kushtetutës ishte një masë *in generis* që synonte të pengonte përdorimin e dorëheqjes si një mjet për të shmangur procesin e *vetting*-ut dhe për t'u kthyer në sistemin e drejtësisë pas një kohe të shkurtër. Një gjë e tillë do të dëmtojte qëllimin e reformës duke u përpyetur që të krijohej një shkëputje nga e shkuara dhe të krijoheshin mundësi për pajtimin e shtetit dhe të shoqërisë, dhe për ndërtimin e një shoqërie demokratike. Skema e dorëheqjes synonte të ulte ngarkesën e punës së organeve të rivlerësimit për t'u mundësuar që të përfundonin procesin e rivlerësimit pa humbje kohe dhe në mënyrë efektive. Pas dorëheqjes së saj, kërkuesja nuk ushtroi ndonjë funksion në sistemin e drejtësisë, gjë që do t'i mundësonte të vijonte procesin e *vetting*-ut. Nga ana tjetër, ajo kishte zgjedhur të punësohej jashtë sistemit të drejtësisë. Organet e *vetting*-ut nuk kishin zgjidhje përveç se të zbatonin kërkesat e nenit G dhe

të urdhëronin ndalimin. Duke pasur parasysh kohëzgjatjen e procesit të *vetting*-ut për nëntë vite, ndalimi prej pesëmbëdhjetë vitesh nuk ishte i paarsyeshëm, nëse mbahen në konsideratë qëllimet e atij procesi.

47. Neni G nuk ndikonte në mundësinë e kërkueses për të ushtruar profesionin e saj. Kërkuesja nuk kishte humbur ndonjë titull, nivel shkencor ose detyrë publike dhe vazhdonte që të gëzonte të njëjtat të drejta si më parë. Ajo punonte për një projekt të rëndësishëm ndërkombëtar me synimin për të ulur ngarkesën me çështje të Gjykatës së Lartë. Kjo punë ishte zgjedhur prej saj dhe i përshtatej kontekstit të saj profesional të lavdërueshëm dhe pritshmërive të saj profesionale. Ushtrimi i një profesioni nuk mund të kufizonte ushtrimin e një detyre publike ose funksioni publik. Për shembull, ushtrimi i profesionit të avokatit (i pranuar në Avokati) do të mbështetej në një zgjedhjen e vet individit, pasi ky i fundit të plotësonte disa kritere të caktuara, ndërsa një post ose detyrë në gjyqësor kishte të bënte me ushtrimin e një pjese të sovranitetit të shtetit. Për këtë arsye, duhej të përmbusheshin “kriteret e vlerësimit” të zbatueshme në kontekstin e një reforme të thellë në sistemin e drejtësisë.

2. Kërkuesja

48. Fakti se kërkuesja kishte një punë nuk ishte i mjaftueshëm për të përjashtuar zbatueshmërinë e nenit 8 të Konventës. Ajo ishte e kufizuar në të drejtën e saj për të zgjedhur punësimin e saj në kushte të drejta, duke u varur vetëm në kritere të qarta dhe jo arbitrare, dhe në përputhje me kompetencat profesionale. Mundësia për të pasur zgjedhjen të largohet nga, dhe të aplikojë për, një punë është pjesë e së drejtës së një personi për zhvillim personal dhe integritet. Në këto rrethana, kërkuesja ka pasur të drejtën për të hequr dorë si këshilltare në Gjykatën Kushtetuese, sepse ajo kishte gjetur një mundësi tjetër punësimi më të mirëpaguar, që ajo e konsideronte më të përshtatshme për zhvillimin e saj profesional dhe personal në atë periudhë. Gjithashtu, ajo kishte të drejtën, kur të lindte mundësia, të aplikonte për t'u bërë gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, pasi t'i nënshtrohej procesit të *vetting*-ut në të njëjtat kushte si kandidatët e tjerë. Ndalimi prej pesëmbëdhjetë vitesh, dhe me mundësi për të gjithë jetën, për të aplikuar për cilindo pozicion në gjyqësor kishte ndikuar në të drejtat e saj



referuar nenit 8 sipas qasjes së mbështetur në arsye dhe asaj të mbështetur në pasojë.

49. Duke iu referuar *travaux preparatoires* të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi (shih paragrafin 20 më sipër), kërkuesja argumentonte se Parlamenti e konsideronte nenin G të aneksit të Kushtetutës, të interpretuar së bashku me nenin 56 të Ligjit të Rivlerësimit që e zbatonte atë, si hapjen e një “dere për ata persona që dëshirojnë të dorëhiqen” gjë që do të çonte “në një nivel më të lartë të pastrimit të sistemit”. Ligjvënisi ishte i mendimit se përpjekja për të fshehur pasuritë e fituara ishte rezultat i korrupsionit, duke vendosur në këtë mënyrë një sanksion që i ndalonte për pesëmbëdhjetë vite të aplikonin për një post në gjyqësor. KPA-ja jepte të njëjtin interpretim në vendimin nr. 1/2018 (shih paragrafin 25 më sipër). Përpara Gjykatës, qeveria kishte pranuar se arsyetimi për ndërprerjen e procedurave, parashikuar në nenin G të aneksit të Kushtetutës, ishte për përjashtimin e individëve të cilët nuk kishin integritet dhe profesionalizëm në sistemin e drejtësisë. Kjo nënkuptonte se kërkuesja, si person i sanksionuar në mbështetje të këtij parashikimi, nuk i kishte këto cilësi, dhe duhej të “largohej” nga sistemi i drejtësisë. Ajo konsiderohej si një person të cilit nuk mund t’i besohej që të punonte në sistem dhe pasojat negative të atij cilësimi do të zgjasnin për të paktën pesëmbëdhjetë vite. Një gjë e tillë ishte dëmtuese për reputacionin, karrierën, zhvillimin personal dhe profesional të kërkueses si avokate në Shqipëri, dhe ndikonte në marrëdhëniet e saj me rrethin e saj të brendshëm, duke përfshirë familjen, miqtë dhe kolegët e saj.

50. Nuk është e arsyeshme që të arrihet në përfundimin se cilido person që dorëhiqej nga detyra nuk kishte cilësitë e sipërpërmendura. Përjashtimi nga e drejta për të aplikuar për cilindo pozicion në gjyqësor në Shqipëri për vite me radhë ndikonte në të ardhmen e saj profesionale, dhe, për pasojë, në pagën e saj dhe në pensionin në të ardhmen. Në periudhën konkrete, situata e saj financiare nuk kishte pësuar një rënie të madhe krahasuar me fitimet e saj në Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, stabiliteti i saj në punësim ishte në rrezik, pasi në vitin 2021 ajo ishte përfshirë në projekte ndërkombëtare të financuara vetëm në bazë vjetore. Teksa mbante pozicionin e avokates së lartë/drejtueses së ekipit në vitin 2021, paga e saj ishte më e ulët sesa paga si gjyqtare në Gjykatën

Kushtetuese, një pozicion me shumë më tepër potencial për zhvillimin profesional dhe intelektual, dhe një arritje personale shumë më prestigjioze. Mundësia e saj për të pasur një punë stabël në fushën e drejtësisë që do të korrespondonte me kualifikimet dhe eksperiencën e saj profesionale ishte reduktuar në masën ku ushtrimi i profesionit të saj bëhej pothuajse i pamundur.

51. Veçanërisht, kërkuesja humbi mundësinë për të krijuar dhe ruajtur mundësitë profesionale në sistemin e drejtësisë në Shqipëri gjatë kësaj periudhe. Përpara ndalimit, sipas formimit, eksperiencës dhe kapaciteteve të saj si në gjyqësor dhe në fushën akademike, ajo kishte të drejtën të aplikonte për pozicione të larta në gjyqësorin shqiptar. Duke u perceptuar nga komuniteti i gjyqësorit në Shqipëri si një person të cilit i mungonte integriteti dhe profesionalizmi, marrëdhënia e saj me të tjerët, dhe veçanërisht me anëtarët e komunitetit ligjor në Shqipëri, kishte vuajtur ndjeshëm.

52. Thelbi i ankesës së kërkueses nuk kishte të bënte me vlerësimin e të drejtave për t’u emëruar si gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, por në faktin se KED-ja refuzonte të vlerësonte cilësitë e saj profesionale për shkak të dorëheqjes së saj.

53. Edhe pas pesëmbëdhjetë vitesh, nenet 28 dhe 36, të ligjit nr. 96/2016, që rregullonin pranimin në trajnimin fillestar dhe emërimin si magjistratë mund të përjashtonin kërkuesen për jetë nga e drejta për të aplikuar për çfarëdo posti në gjykata apo prokurori, sepse ajo kishte qenë subjekt i një “sanksioni” sipas interpretimit të atij ligji. Në praktikë, ajo u përjashtua edhe nga çdo detyrë tjetër publike.

B. Vlerësimi i Gjykatës

54. Kolegji i Posaçëm i Apelit kishte vendosur ndaj kërkueses një ndalim të mundshëm për t’u emëruar, për pesëmbëdhjetë vite, si gjyqtare apo prokurorë në cilëndo shkallë, si anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor apo Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurorë e Përgjithshme (shih paragrafin 22 më sipër). Ky ndalim ishte i zbatueshëm ndaj subjekteve të rivlerësimit të cilët hoqën dorë nga detyra gjatë procesit të rivlerësimit tranzitor (shih *Xboxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, §§ 391-93, 9 shkurt 2021).

55. Gjykata do të shqyrtojë fillimisht argumentet e qeverisë për aspektin nëse në rrethanat specifike të çështjes konkrete, ndalimi sillte një “ndërrhyrje” në të drejtën për respektimin e jetës private sipas nenit 8 të Konventës.



1. Parime të përgjithshme

56. Gjykata përsërit në fillim se neni 8 nuk garanton, si të tillë, të drejtën për t'u emëruar në një post apo detyrë në shërbimin publik (shih *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, nr. 43391/18 dhe 17766/19, §§ 55, 12 tetor 2021, dhe *Frezadou kundër Greqisë*, nr. 2683/12, § 28, 8 nëntor 2018; shih edhe *Lorenzo Bragado dhe të Tjerë kundër Spanjës*, nr. 533193/21 dhe 5 të tjerë, §§ 82 dhe 119, 22 qershor 2023).

57. Gjithashtu, Gjykata thekson praktikën e saj gjyqësore për zbatueshmërinë e nenit 8, në lidhje me mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë, kryesisht, me marrëdhëniet e punësimit tashmë ekzistuese, duke përfshirë rezultate të tilla si shkarkimi nga detyra ose ulja në detyrë, dhe pasojat “për jetën private” që lindnin nga këto rezultate (shih *Denisov kundër Ukrainës* [DHM], nr. 76639/11, §§ 92–117, 25 shtator 2018). Në këto kontekste, aspektet tipike të “jetës private”, që mund të ndikoheshin, përfshijnë rrethin e brendshëm të dikujt, mundësinë për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie me të tjerë, dhe reputacionin e këtij personi. Në rastin kur ngrihet çështja e “jetës private” për shkak të pasojave të një mase me efekte negative, pragu i seriozitetit të aspekteve të sipërpërmendura përbën një rëndësi të madhe. I takon kërkujes që të provojë bindshëm se në çështjen e tij apo të saj është arritur ky prag, si edhe të provojë pasojat shumë serioze të masës së kundërshtuar, që ndikojnë në jetën e tij apo të saj private në një shkallë shumë serioze. Vuajtja e një kërkuesi vlerësohet duke krahasuar jetën e tij apo saj përpara dhe pas masës në fjalë. Kërkuësja duhet të përcaktojë dhe provojë natyrën, dhe masën e vuajtjes, që do të kishte një lidhje rastësore me masën e kundërshtuar (shih *Denisov*, cituar më sipër, § 117, dhe *Gyulumyan dhe të Tjerë kundër Armenisë* (vendim), nr. 25240/20, § 88, 21 nëntor 2023).

58. Për sa i përket “ndërrhyrjes” së pretenduar për atë që kërkuësja kërkon të mbrojë sipas nenit 8 të Konventës, Gjykata thekson se në lidhje me respektimin e nenit 34, një kërkuës duhet të ketë treguar se ai/ajo është ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga masa e kundërshtuar. Detyra e Gjykatës është të përcaktojë nëse mënyra sipas së cilës janë zbatuar apo kanë ndikuar te kërkuësja ligji dhe praktika e brendshme kanë bërë shkaktuar shkelje të Konventës. Konsideratë duhet të mbahet jo vetëm ndaj pozicionit formal në periudhën kur u depozitua ankesa pranë Gjykatës, por ndaj të gjitha rrethanave të çështjes konkrete, duke përfshirë çdo

zhvillim përpara datës së shqyrtimit të çështjes nga Gjykata (shih *Tănase kundër Moldavisë* [DHM], nr. 7/08, § 105, GJEDNJ 2010; shih edhe *Thanza kundër Shqipërisë*, nr. 41047/19, § 134, 4 korrik 2023).

2. Zbatimi i parimeve në çështjen konkrete

59. Në çështjen konkrete, Gjykata duhet të përcaktojë, për sa pretendohet, se neni 8 është i zbatueshëm *ratione materiae* për faktet e çështjes, nëse kërkuësja është ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e saj profesional dhe në zgjedhjet e karrierës nga ndalimi prej pesëmbëdhjetë vitesh të vendosur ndaj saj, dhe nëse po, deri në çfarë mase. Gjykata do të shqyrtojë së pari pretendimet e kërkuësës në lidhje me aksesin në detyra të larta në sistemin e drejtësisë, të ndjekura nga ndikimi i pretenduar ndaj karrierës dhe reputacionit të saj më gjerësisht.

a) Pretendimi për refuzim për të hyrë në pozicione të larta në sistemin e drejtësisë

60. Gjykata vëren se përpara ndalimit, kërkuësja nuk kishte mbajtur kurrë ndonjë nga pozicionet ose postet e listuara në nenin G të aneksit të Kushtetutës, veçanërisht, atë të një “magjistrati” sipas kuptimit të ligjit shqiptar, që është një gjyqtar apo prokuror (krahaso *Lekavičienė kundër Lituanisë*, nr. 48427/09, §§ 37–38, 27 qershor 2017, dhe *Gloveli kundër Gjeorgjisë*, nr. 18952/18, § 37, 7 prill 2022). Pretendimi për ndërhyrje në ushtrimin e saj të çdo të drejte sipas interpretimit të nenit 8 të Konventës nuk kishte lidhje me ndonjë marrëdhënie punësimi ekzistuese apo të mëparshme në sistemin e drejtësisë.

61. Kërkuësja nuk pati sukses me aplikimin e saj për t'u pranuar në Shkollën e Magjistraturës, që është e vetmja rrugë për t'u emëruar në shumicën e posteve dhe pozicioneve të përmendura në nenin G të aneksit të Kushtetutës, më konkretisht si një gjyqtarë karriere apo prokurorë karriere (krahaso *Bigaeva kundër Greqisë*, nr. 26713/05, §§ 18 dhe 24, 28 maj 2009, dhe *Oktay Alkan kundër Turqisë*, nr. 24492/21, §§ 41–42, 20 qershor 2023). Si rezultat, ajo nuk kishte mundësi të ndiqte pozicionet e karrierës në degët e gjyqësorit apo të sistemit të prokurorisë (shih paragrafët 28–31 më sipër, për dispozitat përkatëse të ligjit shqiptar). Gjykata vëren se reformat e vitit 2016 në sistemin e drejtësisë krijonin specifikisht një rrugë tranzitore për këshilltarët ligjorë në Gjykatën Kushtetuese për të ndjekur karrierën si magjistrat, nëse ata ishin të



suksesshëm në procesin e tyre të rivlerësimit, si edhe pranoheshin në Shkollën e Magjistraturës.

62. Duke pasur në konsideratë legjislacionin vendas (shih paragrafët 32–40 më sipër), situatën në të cilën kërkuesja e gjeti veten pas dorëheqjes si këshilltare ligjore i la asaj një rrugë të ngushtë aksesi në një numër të vogël pozicionesh të nivelit të lartë për të cilat ajo mund të kishte aplikuar, në parim, dhe në mungesë të ndalimit prej pesëmbëdhjetë vitesh. Këto opsione do të ishin të kufizuara për t'u bërë anëtar si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese; me një numër të vogël vendesh në Gjykatën e Lartë (aktualisht katër vende të rezervuara për avokatët nga jashtë gjyqësorit); pese anëtarë laikë (jo magjistratë) në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë; Prokuror i Përgjithshëm dhe Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

63. Ndalimi prej pesëmbëdhjetë vitesh zbatohet shprehimisht për shumicën e këtyre pozicioneve. Qeveria ka ngritur dyshime për anëtarësimin si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), që nuk është një organ gjyqësor, e rrëzoi kandidaturën e kërkueses për një afat nëntëvjeçar duke iu referuar ndalimit prej pesëmbëdhjetë vitesh të vendosur nga KPA-ja. KED-ja nuk ofroi ndonjë arsytim të zgjeruar se përse, sipas saj, ndalimi sipas nenit G të aneksit të Kushtetutës, në lidhje me anëtarësimin si gjyqtar në “të gjitha nivelet” zbatohet edhe për Gjykatën Kushtetuese, që nuk është pjesë e gjyqësorit të zakonshëm (shih paragrafët 28 dhe 39 më sipër). Kërkuesja nuk e kundërshtoi vendimin e KED-së, mbi këtë arsye apo ndonjë tjetër. Qeveria argumentoi se ky pozicion i veçantë si gjyqtar nuk është subjekt i ndalimit, por ajo nuk e provoi me fakte pretendimin e saj duke iu referuar praktikës gjyqësore përkatëse, apo historikut legjislativ. As kërkuesja nuk u angazhua me interpretimin e qeverisë, duke insistuar se ndërhyrja e pretenduar në nenin 8 të Konventës vinte nga ndalimi i vendosur nga KPA-ja në procedurat e *vetting*-ut. Megjithatë, as KPA-ja dhe as ndonjë gjykatë tjetër nuk rezultojnë të kenë dhënë interpretim përfundimtar për faktin nëse neni G zbatohet për pozicionin si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata nuk do të hyjë më tej në këtë çështje pasi ankesa e kërkueses, në çdo rast, është e papranueshme për arsyet e përcaktuara më poshtë.

64. Të gjithë pozicionet e lartë të përcaktuar në paragrafin 62 më sipër janë të hapur për avokatët me

eksperiencë (jo magjistratë), të cilët duhet të përmbushin një sërë kërkesash shtesë të detajuara. Për sa i përket procesit të mëpasshëm të përzgjedhjes, ekzistojnë një sërë filtrash ose mekanizmesh profesional për përzgjedhje paraprake, prej të cilëve del një listë e kandidatëve kryesorë pretendent, njëri prej të cilëve, më pas, emërohet ose përzgjidhet nga organi përfundimtar vendimmarrës: më konkretisht Parlamenti për Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe Inspektorin; Presidenti i Republikës me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë; dhe Presidenti, Parlamenti dhe Gjykata e Lartë secili emëron tre gjyqtarë për Gjykatën Kushtetuese, sipas listës me emrat e përzgjedhur (tre zgjedhje për vakancë) të përgatitur nga KED-ja. Emërimet parlamentare kryesisht përbëhen nga një shumicë prej dy të tretash, ose një shumicë prej dy të tretash të të gjithë anëtarëve për Këshillat.

65. Të gjitha këto pozicione, duke përfshirë pozicionin si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, janë pozicione të larta në sektorin e drejtësisë, për emërimin ose pushtetin përzgjedhës të organeve politike, ose, në një rast, të Gjykatës së Lartë. Gjykata vlerëson se neni 8 i Konventës nuk garanton, si të tillë, ndonjë formë përzgjedhshmërie ose për të pasur akses në pozicione të larta në sistemin e drejtësisë (shih *mutatis mutandis* çështjen cituar në paragrafin 56 më sipër). Gjithashtu, në rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata nuk e ka të mundur të spekulojë nëse kërkuesja do të kishte qenë një kandidat që do të përzgjidhej – sipas ligjit vendas – për pozicionet e tilla të larta, apo nëse do të kishte një mundësi reale për t'u konsideruar për këto pozicione. Proceset e nominimit janë komplekse dhe me shumë faza dhe varen, për pjesën më të madhe, nga vendimet e marra nga organet politike (krahaso *Shortall dhe të Tjerë kundër Irlandës* (vendim), nr. 50272/18, §§ 53–61, 19 tetor 2021). Kërkuesja ka testuar vetëm pjesërisht kandidaturën për pozicionin si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese (shih paragrafin 63 më sipër), por jo pozicione të tjera.

66. Për këtë arsye, për sa ka të bëjë me ankimin e kërkueses për efektin negativ të ndalimit prej pesëmbëdhjetë vitesh për të drejtën e saj për t'u përzgjedhur në një numër të vogël pozicionesh të nivelit të lartë në sektorin e drejtësisë, Gjykata vlerëson se neni 8 i Konventës nuk është i



zbatueshëm *ratione materiae* në rrethanat e çështjes konkrete.

b) Pretendimi për ndërhyrje të tjera në jetën private të kërkuases

67. Edhe nëse do të hamendësohej se legjislacioni i *vetting*-ut kufizonte në një masë të caktuar zgjedhjet e karrierës së kërkuases teksa procesi i *vetting*-ut vijonte, është e rëndësishme të vlerësohet nëse natyra dhe fusha e veprimit e një ndërhyrjeje të tillë me jetën private të saj respektonte pragun e kërkuar për zbatimin e nenit 8. Pretendimi i pretenduar vinte nga vendimi i saj për të nisur një punësim tjetër, që ishte jashtë sistemit të drejtësisë dhe që ajo e mendonte se përmbushte aspiratat e saj profesionale në atë periudhë. Ky vendim u mor gjatë procesit të rivlerësimit tranzitor që ishte në vijim (procesi i *vetting*-ut) në sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

68. Ndalimi i mundshëm për disa mundësi punësimi të caktuara nuk sillte – dhe nuk mund të sillte *per se* – ndonjë ndryshim në të ardhurat e kërkuases. Në çdo rast, pas dorëheqjes së saj në vitin 2017, dhe pas ndërprerjes të procedurave të *vetting*-ut në vitin 2019, ajo vijoi me një punësim fitimprurës që ishte më i mirëpaguar, dhe më pas ishte të paktën i krahasueshëm me të ardhurat e saj si këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese.

69. Pretendimi për ndërhyrje nuk shkaktoi, në vetvete, heqjen e kërkuases nga “profesioni”, për të cilin tashmë ishte trajnuar dhe të cilin e kishte praktikuar deri në dorëheqjen e saj (krahaso *Bigaeva*, §§ 23–25, *Lekavičienė*, §§ 37–38, të dy të cituar më sipër, shih edhe *Convertito dhe të Tjerë kundër Rumanisë*, nr. 30547/14 dhe 4 të tjerë, §§ 29 dhe 37, 3 mars 2020). Ajo nuk aspironte më për një pozicion fitimprurës si këshilltare ligjore. Nga parashtimet rezultoi se thelbi i ankesës së saj ka të bëjë me aksesin – si në vakanca në vitin 2018 dhe çdo vakancë në të ardhmen – në pozicione në gjyqësor dhe më specifikisht në mandatin nëntëvjeçar në Gjykatën Kushtetuese.

70. Legjislacioni për *vetting*-un, në thelb, kërkonte që një person të ishte në njërin prej kategorive me të drejtën për t'u rivlerësuar për të bërë një zgjedhje: ose të tërhiqej nga zgjedhja për të ndryshuar në mënyrë vullnetare statusin e punësimit në sistemin e drejtësisë për periudhën e procesit të *vetting*-ut, ose të përballej me rrezikun që të ndalohej nga e drejta për të pasur akses në pozicionet e gjyqësorit apo të prokurorisë për një periudhë pesëmbëdhjetëvjeçare.

Procedurat e *vetting*-ut kërkonin kohë, gjatë së cilës një subjekt rivlerësimi do të duhej të vijonte të shërbente brenda sistemit të drejtësisë (shih një shembull në paragrafin 26 më sipër). Procesi i *vetting*-ut nisi efektivisht në vitin 2018 dhe procedurat e rivlerësimit në çështjen e kërkuases filluan në maj 2018 dhe morën edhe një vit tjetër (shih paragrafët 5 dhe 15 më sipër). Megjithatë, Gjykata vlerëson se kufizimi i mësipërm nuk ushtronte *per se* një barrë të tepërt në rrethanat specifike të çështjes dhe sipas natyrës së jashtëzakonshme dhe qëllimit detyrues të procesit rivlerësimit tranzitor. Gjykata nuk ka arsye të gjykojë se vendimi i kërkuases për t'u dorëhequr në vitin 2017 është udhëhequr nga ndonjë arsye tjetër përveçse aspiratës për zhvillim profesional me anë të një mundësie punësimi më tërheqëse dhe nuk lidhet me ndonjë rrethanë të vështirë që kishte të bënte me jetën e saj private apo familjare (shih paragrafin 26 më sipër).

71. Qeveria argumentoi se ndalimi për pesëmbëdhjetë vitesh, që zbatohet për të gjitha dorëheqjet që çonte në ndërprerjen e procesit të *vetting*-ut, pavarësisht motivit, kishte për qëllim t'i ndalonte personat e dorëhequr nga sistemi i drejtësisë gjatë procesit të rivlerësimit që të riktheheshin në këtë sistem me anë të një “dere të pasme”. Një arsyetim tjetër për këtë vendim kishte të bënte me nevojën për të garantuar shpejtësinë dhe efikasitetin e procesit të rivlerësimit tranzitor, teksa i mundësonte personave që dëshironin të vijonin të ndiqnin një karrierë në sistemin e drejtësisë një mundësi për ta bërë një gjë të tillë pas përfundimit me sukses të procesit të rivlerësimit (shih paragrafin 31 më sipër). Gjykata mund të pranojë se dallimi midis llojeve të ndryshme të dorëheqjeve gjatë kësaj periudhe mund të kishte krijuar një rrugë ligjore që mund ta ketë bërë të gjithë skemën e dorëheqjes në tërësi jofunksionale, pavarësisht vendosjes së një barre të caktuar për ata që kërkonin në mirëbesim një ndryshim të menjëhershëm në karrierë.

72. Për qëllimet e çështjes konkrete, mjafton të theksohet se me anë të kontaktimit të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm me forcat kryesore të vendeve të tyre, shoqërive të tyre dhe nevojave të tyre, autoritetet legjislative dhe gjyqësore janë në pozicionin më të mirë për të vlerësuar vështirësitë specifike në ruajtjen e rendit demokratik në shtetin e tyre (shih *Animal Defenders International kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nr. 48876/08, §111, GJEDN] 2013 (ekstrakte)). Për këtë arsye, shteti



duhet t'i jepet diskrecion për këtë vlerësim sipas shtetit dhe kompleks, që është me rëndësi thelbësore për zgjedhjet legjislative (ibid.) të tilla si ato që janë në dilemë në çështjen konkrete (shih në lidhje me këtë *Xboxhaj*, cituar më sipër, §§ 391-93). I takon shtetit të vlerësojë rrezikun e abuzimit, nëse lehtësohet një masë e përgjithshme. Një masë e përgjithshme mund të jetë një mjet më praktik për arritjen e qëllimit legjitim sesa një parashikim që lejon shqyrtimin rast pas rasti, teksa ky i fundit mund të linte vend për një rrezik për pasiguri të mjaftueshme, për ndjekje gjyqësore, shpenzime dhe vonesa, si edhe për diskriminim dhe arbitraritet (shi, *mutatis mutandis*, *Animal International*, cituar më sipër, §§ 108 dhe 110-11).

73. Gjithashtu, ekziston relevanca që ndalimi i kundërshtuar të kishte të bënte me aksesin në një profesion në një fushë të kufizuar në sektorin publik, në këtë çështje, kryesisht pozicione të nivelit të lartë në sistemin gjyqësor (shih paragrafët 60–66 më sipër). Nuk ka arsye për të menduar se ndalimi shtrihej deri në punësimin në shërbimin civil ose në ushtrimin e profesionit të avokatit. Fakti qëndron se që prej vitit 2019, kërkueses nuk i është ndaluar për shkak të ndërprerjes së procesit të *vetting*-ut ose për shkak të atij ndalimi që të angazhohet në ndonjë profesion specifik fitimprurës në fushën e së drejtës jashtë sistemit të drejtësisë. Ajo ka vazhduar të punojë deri në prill 2020 për projektin e USAID-it, dhe më pas në një pozicion të ngjashëm.

74. Gjykimet e mësipërme janë të mjaftueshme për Gjykatën që të arrijë në përfundimin se për sa ka të bëjë me ankesën e kërkueses për efektet negative të ndalimit prej pesëmbëdhjetë vitesh në zgjedhjet e saj të karrierës ose në avancimin profesional në përgjithësi, këto efekte nuk janë mjaftueshëm të rënda për të arritur pragun për zbatimin e nenit 8 të Konventës, nën kreun për “jetën private”.

75. Së fundmi, në lidhje me argumentin e kërkueses se masa e kundërshtuar cenonte reputacionin e saj, Gjykata përsërit praktikën e saj gjyqësore për procedurat disiplinore ndaj anëtarëve të gjyqësorit, duke marrë në konsideratë faktin se disa rezultate të atyre procedurave, të tilla si shkarkimi nga detyra, mund të mbajnë një nivel të madh stigme (shih *Thanza*, cituar më sipër, § 121). Në çështjen konkrete, kërkuesja, një ish-këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese, nuk ishte përgjegjëse për ndonjë shkelje etike të ndonjë forme apo për ndonjë shkelje disiplinore. Sipas konfir-

mimit të vet qeverisë, kërkuesja ishte dhe vazhdon të jetë një profesioniste e vlerësuar në fushën e drejtësisë (shih paragrafin 47 më sipër). Karriera e saj ka qenë në pozicione të larta (shih paragrafët 6, 8 dhe 19 më sipër). Megjithatë, asaj i është dashur që të përballlet me pasojën e parashikueshme të largimit nga pozicioni i saj i mëparshëm në sistemin e drejtësisë në mënyrë të vullnetshme në mes të atij që konsiderohej si një proces i rëndësishëm tranzitor në reformën e thellë të sistemit të drejtësisë. Kërkuesja ishte thjesht një subjekt i një mase me zbatim të përgjithshëm (shih edhe paragrafët 71–72 më sipër), të vendosur për të gjithë subjektet e *vetting*-ut që ishin dorëhequr në atë periudhë, pavarësisht ndonjë arsye konkrete apo të supozuar, apo motivit për këtë dorëheqje.

76. KPA-ja shprehu dyshime në lidhje me gatishmërinë e kërkueses për t'u nënshtruar procesit të *vetting*-ut, duke pasur parasysh pozicionin e saj në favor për të ndërprerë procedurat e *vetting*-ut, teksa kërkonte për moszbatimin e ndalimit prej pesëmbëdhjetë vitesh. Megjithatë, vendimi i KPA-së nuk përmbante asnjë deklaratë ku të shprehej se ajo nuk ishte e përshtatshme për të shërbyer në sistemin e drejtësisë (krahaso *Juszczyżyn kundër Polonisë*, nr. 35599/20, §§ 233-34, 6 tetor 2022; *Sevdari kundër Shqipërisë*, nr. 40662/19, § 61, 13 dhjetor 2022; dhe *Ovcharenko dhe Kolos kundër Ukrainës*, nr. 27276/15 dhe 33692/15, § 86, 12 janar 2023). Nuk ka të dhëna për ndonjë vërejtje negative të individualizuar të bërë nga autoritetet vendase në lidhje me performancën profesionale, personalitetin, vlerat morale, apo karakterin (shih *Gyulumyan dhe të Tjerë*, cituar më sipër, § 93).

77. Rezulton se neni 8 i Konventës është i pazbatueshëm në lidhje me këtë aspekt të çështjes.

c) Përfundim

78. Për këtë pjesë, Gjykata nuk ka arsye të dyshojë se dorëheqja e kërkueses e shoqëruar me një punësim të ri mbështetej në aspiratën e saj për zhvillim profesional dhe vetëpërmbytje. Megjithatë, duke pasur në konsideratë vlerësimet e mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se efektet negative të ndërhyrjes së pretenduar në të drejtën për respektimin e jetës private – duke përfshirë reputacionin e saj profesional, përpjekjen e saj për të qenë pjesë e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, apo më në përgjithësi në perspektivat e saj për karrierën – ose nuk ishin në fushën e veprimtimit të mbrojtjes ose nuk kalonin pragun e rëndësisë/seriozitetit në



mënyrë që të përfshihej neni 8 i Konventës në rrethanat specifike të çështjes.

79. Për rrjedhojë, ankesat e kërkuases nuk përputhen *ratione materiae* me parashikimet e Konventës sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) dhe duhet të rrëzohen në përputhje me nenin 35 § 4.

Për këto arsye, Gjykata, me shumicë,
E deklaroi kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 2 maj 2024.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE

Pere Pastor Vilanova
KRYETAR

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 141(891), datë 22.2.2024, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Patrik Boshi, me atësi Pjetër dhe me amësi Dritë, i datëlindjes 11.2.2004, lindur në Shkodër, si dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të kërkuësve, shtetasve Dritë Boshi dhe Pjetër Boshi.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 140(890), datë 22.2.2024, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Erjon Sherri, me atësi Refat dhe me amësi Tone, i datëlindjes 6.3.2004, lindur në Shkodër, si dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të kërkuësve, shtetasit Elis Sherri.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 151(967), datë 27.2.2024, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Ardian Peniku, i datëlindjes 14.5.1972, me atësi Ded dhe me amësi Linë, lindur dhe banues në Shkodër, si dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të kërkuësve, shtetasit Gjovalin Peniku.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 256(1652), datë 2.4.2024, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasë Ganxhe Mustali, me atësi Ali dhe me amësi Tale, e datëlindjes 28.12.1956, lindur dhe banuese në Shkodër, si dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë ligjore të shtetasë, Naxhije Ragip Ligataj.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 181(1179), datë 5.3.2024, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Ermal Dibra, me atësi Shaqir dhe me amësi Erma, lindur më 5.9.2005, në Shkodër, si dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të shtetasë Nereda Dibra.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 235(1541), datë 26.3.2024, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Rigail Lishi, i datëlindjes 10.6.1974, lindur dhe banues në Shkodër, si dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të kërkuësve, shtetasit Fatbardh Lishi.



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 112 lekë